

## RELACION

### PËR PROJEKT VENDIMIN

#### PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE TË STREHIMIT SOCIAL NË NIVEL KOMBËTAR

##### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim bazohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” me propozimin e ministrit të Ekonomisë, dhe Inovacionit.

##### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar” është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar. Ky projektakt nuk është i parashikuar në PPAP 2026

##### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon krijimin e bazës e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar, i cili shërben për të mbajtur, ruajtur dhe përdorur lehtësisht të dhënat si dhe për të identifikuar nevojat që janë realizuar deri më tani si dhe ato që duhet të realizohen. Gjithashtu, kjo bazë e të dhënave përfshin institucionet bazë që janë zbatuese të ligjit për strehimin social, duke pasqyruar kështu një situatë reale të hapave që janë ndërmarre me zbatimin e ligjit organik.

##### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”

##### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim që të përcaktojë një bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave lidhur me kërkesat për strehim social të depozituara pranë autoriteteve vendore sipas ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar trajtimin e tyre, si dhe të fondit të strehimit social dhe përdorimit të tij.

Projektvendimi përbëhet nga 14 pika, si vijon:

1. Ngritjen e bazës së të dhënave në nivel kombëtar të strehimit social e cila administrohet nga njësi përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin dhe njësi përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Përmbajtja e bazës së të dhënave publikohet në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për strehimin dhe njësi të vetëqeverisjes vendore.
2. Baza e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar, përcakton të dhënat parësore dhe dytësore, dhënësin/dhënësit e informacionit, ndërveprimin me baza të tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.
3. Njësi përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin dhe në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar, dhe ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat në nivel vendor të informacionit.
4. Baza e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar përbën një bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave lidhur me kërkesat për strehim social të depozituara pranë autoriteteve vendore sipas ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe trajtimin e tyre, si dhe të fondit të strehimit social dhe përdorimit të tij.
5. Të dhënat e bazës së të dhënave në nivel kombëtar të strehimit social përditësohen çdo 3 (tre) muaj nga personat përgjegjës për këmbimin e informacioneve dhe mbajtjen e kontakteve me qëllim ndërveprimin në kuadër të zbatimit të programeve të strehimit social në ministrinë përgjegjëse për strehimin, mbrojtjen sociale, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor, si dhe në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6. Baza e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar përmban të dhëna për:
  - a. Autoritetet publike të ngarkuara për qëllimet e strehimit social;
  - b. Pikat e kontaktit dhe adresat respektive të strukturave përgjegjëse për strehimin social;

7. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:
- a. Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna, të cilat grumbullohen nga ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe përfshijnë:
    - i. nevojat për strehim, me programe sociale strehimi;
    - ii. inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike;
    - iii. kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira;
    - iv. numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit;
    - v. sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash;
    - vi. sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash;
    - vii. numrin e banesave të ndërtuara me kosto të ulët;
    - viii. inventarin e godinave të dala jashtë funksioni, pronë publike, të cilat parashikohen të shtohen në fondin publik të banesave sociale;
    - ix. nivelin e qerasë mesatare të miratuar me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore;
    - x. sipërfaqen dhe numrin e banesave sociale të përfituara nga zbatimi i nenit 19 i ligjit për strehimin social;
    - xi. numrin e banesave në rrezik shembjeje duke përcaktuar adresën e saktë;
    - xii. strategjitë kombëtare 10-vjeçare të strehimit;
    - xiii. programet 5-vjeçare të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehimin;
    - xiv. fondet e buxhetit të shtetit për mbështetjen e realizimit të programeve vjetore të strehimit, bazuar edhe në kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore;
    - xv. informacionet për administrimin e kërkesave për strehim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
    - xvi. koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave;
    - xvii. shpërndarjen e fondeve që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financimi;
    - xviii. realizimin e investimeve në programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime nga buxheti i shtetit;
    - xix. programet e strehimit që zbaton Enti Kombëtar i Banesave.
  - b. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga:
    - i. Sistemi i të dhënave REVALB;
    - ii. Sistemi i të dhënave ROMALB.
8. Dhënës i informacionit për këtë bazë të dhënash janë autoritetet publike, përkatësisht ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria përgjegjëse për strehimin në nivel qendror, njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet personave përgjegjës të tyre, si dhe Enti Kombëtar i Banesave nëpërmjet personave përgjegjës.

9. Niveli i aksesimit në sistemin dhe bazën e të dhënave elektronike të strehimit social në nivel kombëtar është si më poshtë vijon:
- a. Qytetarët kanë nivel aksesi si lexues dhe dërgues të pyetjeve apo komenteve;
  - b. Strukturat përgjegjëse të njërive të vetëqeverisjes vendore kanë akses si administrator dhe përdorues në sistemin e bazës së të dhënave të strehimit social. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, janë si vijon:
    - i. Regjistruues: regjistron informacione përditësuar;
    - ii. Përdorues vetëm lexues: kjo kategori përdoruesish nuk është e lejuar të regjistrojë informacion në sistem. Përdoruesit e kësaj kategorie mund të ekzekutojnë vetëm raporte dhe t'i përdorin ato për qëllime raportimi;
    - iii. Administratorët e sistemit: administratorët e sistemit janë administratorë teknikë, të cilët mirëmbajnë e administrojnë teknikisht sistemin dhe përdoruesit e sistemit.
  - c. Ministria përgjegjëse për strehimin ka akses si administrator dhe përdorues në sistemin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, janë si vijon:
    - iv. Regjistruues:
    - v. Përdorues vetëm lexues: kjo kategori përdoruesish nuk është e lejuar të regjistrojë informacion në sistem. Përdoruesit e kësaj kategorie mund të ekzekutojnë vetëm raporte dhe t'i përdorin ato për qëllime raportimi;
    - vi. Administratorët e sistemit: administratorët e sistemit janë administratorë teknikë, të cilët mirëmbajnë e administrojnë teknikisht sistemin dhe përdoruesit e sistemit.
10. Sistemi bën të mundur gjenerimin e raporteve si dhe jep informacion të përditësuar mbi të gjitha raportet sipas pikës 7 të këtij vendimi dhe sipas nevojave të ministrisë përgjegjëse për strehimin.
11. Çdo nëpunës që ka akses në bazën e të dhënave në nivel kombëtar respekton legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.
12. Baza e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar ndërvepron me bazën e të dhënave të strehimit social në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe bazën e të dhënave të autoriteteve publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "*Për bazat e të dhënave shtetërore*".
13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *softëare* dhe *hardëare* të bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, si dhe të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin si dhe të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

#### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim u hartua nga Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) si ministria përgjegjëse për strehimin.

Projektvendimi është dërguar për mendim te Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore-Vetëqeverisjes Vendore, Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektvendim ka kosto financiare të cilat nuk mund të parashikohen dot në këtë fazë për shkak të nevojës dhe ekspertizës nga Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**

